



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:220426
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05755486

C.nr.2977/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit R.L. nga Komuna P., të cilin e përfaqëson A.I., avokat në Pejë, sipas autorizimit, kundër të paditurës V.... Sh.P.K, me seli në P., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor A.D., nga Komuna P., me bazë juridike vërtetim pronësie, vlera e kontestit e pa përcaktuar, jashtë seance, me datën 30.05.2024 mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit R.L. nga Komuna P., e parashtruar me datë 18.10.2023, kundër të paditurës V... Sh.P.K, me seli në P., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor A.D., me bazë juridike vërtetim pronësie.

II. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.

Arsyetim

Në këtë gjykatë, paditësi R.L., përmes të autorizuarit të tij, ka parashtruar padi, kundër të paditurës V... Sh.P.K, me seli në P., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor A.D., me bazë juridike vërtetim pronësie.

Gjykata, me datën 08.04.2024, ka pranuar parashtresës e paditësit, përkatësisht nga i autorizuari i tij, me anë të së cilës parashtresë, ka deklaruar se e tërheqë padinë ndaj të paditurës.

Sipas nenit 261 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se I padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*, andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se

plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 261 par.1, 2, 3, 4 dhe 5 lidhur me nenin 387 par.1, pika c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.2977/23, me datë 30.05.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.